

18 zotimet për “Besim për të Drejta”

Ne, aktorët e besimit dhe të shoqërisë civile që punojmë në fushën e të drejtave të njeriut dhe që u mbledhëm në Bejrut më 28-29 mars 2017, shprehim bindjen e thellë se fetë dhe besimet tona fetare përkatëse ndajnë një zotim të përbashkët për të **mbështetur dinjitetin dhe vlerën e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore**. Vlerat e përbashkëta njerëzore dhe dinjiteti i barabartë, pra, janë rrënjët e përbashkëta të kulturave tona. Besimi dhe të drejtat duhet të jenë sfera reciprokisht përforcuese. Shprehja individuale dhe shoqërore e feve apo besimeve bulëzon dhe lulëzon në mjediset ku mbrohen të drejtat e njeriut bazuar në vlerën e barabartë të të gjithë individëve. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e njeriut mund të përfitojnë nga fondacione të rrënjësura thellë, etike dhe shpirtërore, të ofruara nga fetë ose besimet.

Kjo deklaratë për “Besim për të Drejta” i bën thirrje personave që u përkasin feve dhe besimeve në të gjitha rajonet e botës, me qëllim të rritjes së shoqërive kohezive, paqësore dhe respektuese në bazë të një platforme të përbashkët të orientuar kah veprimi të rënë dakord nga të gjithë të interesuarit dhe të hapur për të gjithë aktorët që ndajnë objektivat e saj. Ne vlerësojmë se deklarata jonë për Besim për të Drejta, si edhe pararendësi i saj themelues Plani i Veprimit i Rabatit, janë konceptuar dhe realizuar nën kujdesin dhe me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara që përfaqëson të gjithë popujt e botës, dhe janë begatuar me mekanizmat për të drejtat e njeriut të OKB-së, të tillë si Raportuesit Specialë dhe anëtarët e Trupave të Traktateve.

Plani i Veprimit i Rabatit¹ nga viti 2012 artikulon tre përgjegjësitë specifike bërthamë të prijësve fetarë: (a) Prijësit fetarë duhet të përmbahen nga përdorimi i mesazheve të mostolerancës apo shprehjeve të cilat mund të nxisin dhunë, armiqësi ose diskriminim; (b) Prijësit fetarë gjithashtu kanë një rol vendimtar për të luajtur duke folur në mënyrë të vendosur dhe menjëherë kundër mostolerancës, stereotipave diskriminuese dhe rasteve të gjuhës së urrejtjes; dhe (c) Prijësit fetarë duhet të jenë të qartë se dhuna nuk mund të tolerohet asnjëherë si përgjigje ndaj nxitjes së urrejtjes (p.sh. dhuna nuk mund të arsyetohet me provokim paraprak).

Në mënyrë që të japë efekt konkret sa i përket tre përgjegjësi bërthamë më sipër të artikuluar nga Plani i Veprimit i Rabatit, në të cilin shtetet janë thirrur pozitivisht vazhdimisht, ne formulojmë kartën në vijim të **18 zotimeve për “Besim për të Drejta”**,² duke përfshirë veprimet përcjellëse përgjegjëse:

- I. Përgjegjësia jonë më themelore është që të **ngrihemi dhe të veprojmë për të drejtën e secilit për zgjedhje të lirë** dhe në veçanti për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë apo besimit të secilit. Ne afirmojmë përkushtimin tonë ndaj normave ³ dhe standardeve universale ⁴, duke përfshirë Nenin 18 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i cili nuk lejon asnjë kufizim të çfarëdo lloji të lirisë së mendimit dhe ndërgjegjes ose të lirisë për të pasur ose për të përvetësuar një fe apo besim sipas zgjedhjes së vet. Këto liri, të mbrojtura pakusht nga normat universale, janë gjithashtu të drejta të shenjta dhe të patjetërsueshme sipas mësimave fetare.
 - “S’ka detyrim në fe.” (Kurani 2:256);
 - “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë” (Kurani 18:29);
 - “Dhe në rast se ju duket një gjë e keqe t’i shërbeni Zotit, zgjidhni sot kujt doni t’i shërbeni...” (Jozueu 24:15)
 - “Askush nuk do të detyrojë tjetrin; askush nuk do të shfrytëzojë tjetrin. Secili, çdo individ, ka të drejtën e patjetërsueshme me lindje për të kërkuar dhe për të ndjekur lumturinë dhe vetëpërmbytjen. Dashuria dhe bindja është ligji i vetëm i koherencës shoqërore.” (Guru Granth Sahib, f. 74)
 - “Kur të mbizotërojë liria e ndërgjegjes, liria e mendimit dhe e drejta e fjalës - që do të thotë, kur çdo njeri mund t’i shpreh besimet sipas idealizimit të vet - zhvillimi dhe rritja janë të pashmangshme.” (‘Abdu’l-Bahá)
 - “Njerëzit duhet të synojnë të trajtojnë njëri-tjetrin ashtu si ata do të donin që të trajtohen vetë - me tolerancë, konsideratë dhe dhembshuri.” (Rregulla e Artë)⁵
- II. Ne e shohim këtë Deklaratë për “Besim për të Drejta” si një **standard të përbashkët minimal për besimtarët (qofshin teistë, joteistë, ateistë apo të tjerë)**, bazuar në bindjen tonë se interpretimet e fesë apo besimit duhet të shtojnë në nivelin e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor që parashikojnë ligjet e bëra nga njeriu.

- III. Pasi që fetë janë domosdoshmërisht subjekt i interpretimeve të njeriut, ne zotohemi për të **nxitur angazhimin konstruktiv në të kuptuarit e teksteve fetare**. Si pasojë, të menduarit kritik dhe debati mbi çështjet fetare nuk duhet vetëm të tolerohet, por të inkurajohet si një kërkesë për interpretime të ndritura fetare, në një botë të globalizuar të përbërë nga shoqëritë gjithnjë e më shumëkulturore dhe shumëfetare që vazhdimisht përballen me sfida në zhvillim e sipër.
- IV. Ne marrim detyrimin për të **mbështetur dhe promovuar trajtimin e barabartë** në të gjitha fushat dhe manifestimet e fesë apo besimit dhe për të denoncuar të gjitha format e praktikave diskriminuese. Ne zotohemi për të **parandaluar përdorimin e nocionit “fe shtetërore” për të diskriminuar kundër ndonjë individi ose grupi** dhe ne e konsiderojmë çdo interpretim të tillë si në kundërshtim me njëshmërinë e njerëzimit dhe dinjitetin e barabartë të njerëzimit. Ngjashëm, ne zotohemi për të parandaluar përdorimin e “sekularizmit doktrinar” për reduktimin e hapësirës për pluralizëm fetar apo të besimit në praktikë.
- “Atëherë Pjetri hapi gojën dhe tha: “Në të vërtetë unë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm; (Veprat 10:34)
- V. Ne marrim detyrimin për të **siguruar mosdiskriminim dhe barazi gjinore** në zbatimin e kësaj deklarate për “Besim për të Drejta”. Ne mënyrë specifike ne zotohemi të rishqyrtojmë, secili brenda fushave tona përkatëse të kompetencës, ato kuptime dhe interpretime fetare që duket se përjetësojnë pabarazinë gjinore dhe stereotipat e dëmshëm apo edhe pranojnë e lejojnë dhunën me bazë gjinore. Ne zotohemi për të siguruar drejtësi dhe vlerë të barabartë të të gjithëve, si dhe për të afirmuar të drejtën e të gjitha grave, vajzave dhe djemve të mos iu nënshtruar çfarëdo forme të diskriminimit dhe dhunës, duke përfshirë praktikën e dëmshme të tilla si gjymtimi gjenital femëror, martesat e fëmijëve dhe/ose të detyruara dhe krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit nder.
- “Burri duhet të respektojë gruan e tij më shumë se që e respekton veten dhe ta duajë atë po aq sa e do veten.” (Talmud, Yebamot, 62,b)
 - “Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëllor (në shpërblim).” (Kurani 3:195)
 - “O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin.” (Kurani 49:13)
 - “Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltys së vet, simbas shëmbëlltys së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.” (Zanafilla 1, 27)
 - “Më i miri ndër ju është ai që është më i miri ndaj gruas së tij” (Hadith)
 - “Gruaja është ajo që është një mik dhe partner përjetë. Gruaja është ajo që mban të gjallë garën. Si mund të mendojmë keq për një grua nga e cila kanë lindur më të mëdhenjtë. Nga një grua ka lindur një grua: askush nuk mund të ekzistojë pa një grua”. (Guru Granth Sahib, f. 473)
 - “Bota e njerëzimit është e pushtuar nga dy krahë - mashkulli dhe femra. Për sa kohë që këta dy krahë nuk janë ekuivalentë për nga forca zogu nuk do të fluturojë. Derisa gratë të arrijnë të njëjtën shkallë si burrat, deri sa ajo gëzon të njëjtën arenë të aktivitetit, arritshmëria e jashtëzakonshme e njerëzimit nuk do të realizohet” (Abdu'l-Bahá)
 - “Një qasje gjithëpërfshirëse, holistike dhe efektive ndaj ndërtimit të kapaciteteve duhet të synojë angazhimin e prijësve me ndikim, siç janë ata tradicionalë dhe fetarë [...]” (Rekomandimi i përgjithshëm i përbashkët Nr. 31 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave / komenti i përgjithshëm Nr. 18 i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi praktikën e dëmshme, CEDAW/C/GC/31-CRC/C/GC/18, para. 70)
- VI. Ne zotohemi që të **ngrihemi për të drejtat e të gjithë personave që u përkasin pakicave** në fushat tona përkatëse të veprimit dhe për të mbrojtur lirinë e tyre të fesë apo besimit, si dhe të drejtën e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë dhe efektive në jetën kulturore, fetare, shoqërore, ekonomike dhe publike, siç njihet e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si një standard minimal të solidaritetit midis të gjithë besimtarëve.
- VII. Ne marrim detyrimin për të **denoncuar publikisht të gjitha instancat e avokimit të urrejtjes që nxit dhunë, diskriminim dhe armiqësi**, duke përfshirë edhe ato që çojnë në krime të mizorisë. Ne mbajmë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të denoncuar avokimin e tillë, sidomos kur ai kryhet në emër të fesë apo besimit.
- “Tani ky është urdhri: Bëje për tjetrin për ta bërë atë të bëjë.” (Mbretëria e Mesme e Egjiptit të Lashtë);
 - “Shpaguaj dëmtimin me drejtësi dhe mirësinë me mirësi.” (Konfuçi)
 - “Mos ia bëj shokut tënd atë që është e urryer për ty.” (Talmud, Shabat, 31a)

- “Çfarëdo fjalë që i shqiptojmë, duhet të jenë të zgjedhura me kujdes, ngase njerëzit do t’i dëgjojnë ato dhe do të ndikohen nga ato për të mirë apo për të keq.” (Buddha)
- “Me vetëkontroll dhe duke e bërë dharmën (sjelljen e drejtë) fokusin juaj kryesor, trajtoni të tjerët si e trajtoni veten.” (Mahābhārata)
- “Nuk do të hakmerresh dhe nuk do të mbash mëri kundër bijve të popullit tënd, por do ta duash të afërmin tënd si veten tënde” (Levitiku 19:18)
- “Gjithçka, pra, që ju dëshironi t’ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre, sepse ky është ligji dhe profetët.” (Mateu 7:12)
- “Mos i vesh asnjë shpirti atë që ti nuk do t’ia veshje vetes, dhe mos e thuaj atë që ti do thuaje vetë.” (Bahá'u'lláh)

VIII. Prandaj, ne marrim detyrimin për të krijuar, secili brenda sferave tona përkatëse, politikat dhe metodologjitë për të **monitoruar interpretimet, përcaktimet ose pikëpamjet tjera fetare haptazi në kundërshtim me normat universale të drejtave të njeriut dhe standardeve**, pavarësisht nëse ato janë të theksuara nga institucione formale ose nga individë të vetë-emëruar. Ne synojmë që të marrim përsipër këtë përgjegjësi në mënyrë të disiplinuar objektive vetëm brenda fushave tona përkatëse të kompetencës në mënyrë introspektive, pa gjykuar besimin apo besimet e të tjerëve.

- “Mos gjykoni, që të mos gjykoheni. Sepse ju do të gjykoheni sipas gjykimit me të cilin ju gjykoni; dhe me masën me të cilën ju matni, do t’ju matin të tjerët.” (Bibla, Mateu 7: 1-2)
- “Mësojeni zemrën me mëshirë ndaj të nënshtruarve dhe me dashuri dhe mirësi për ta ... pasi që ata janë të dy llojeve, ose vëlla i yti në fe ose të barabartë me ty në krijim...Pra, shtrini atyre faljen dhe ndjesën, në të njëjtën mënyrë si ju do të donit që Allahu të shtrijë faljen dhe ndjesën e tij për ju” - (Letër nga Kalifi Ali për Malik Ashtarín, Guvernator i Egjiptit)
- “Qëllimi thelbësor i fesë së Perëndisë është për të krijuar unitet midis njerëzve. Manifestimet hyjnore ishin Themeluesit e mjeteve të miqësisë dhe dashurisë. Ato nuk erdhën për të krijuar përçarje, grindje dhe urrejtje në botë. Feja e Perëndisë është shkaku i dashurisë, por në qoftë se ajo është bërë të jetë burim i armiqësisë dhe gjakderdhjes, sigurisht që mungesa e saj preferohet kundrejt ekzistencës së saj; sepse atëherë ajo bëhet satanike, e dëmshme dhe një pengesë për botën njerëzore.” (‘Abdu’l-Bahá)

IX. Ne gjithashtu marrim detyrimin që të përmbahemi nga, të avokojmë kundër dhe bashkërisht të **dënojmë çdo përcaktim gjykues publik nga cilido aktor i cili në emër të fesë synon për të diskualifikuar fenë apo besimin e një individi tjetër** apo një komuniteti tjetër në një mënyrë që do t’i ekspozojë ata ndaj dhunës në emër të fesë ose do t’i privojë të drejtat e tyre njerëzore.

X. Ne marrim detyrimin **për të mos i besuar interpretimeve përjashtuese me pretendim të bazave fetare** në një mënyrë që do t’i instrumentalizojë fetë, besimet apo pasuesit e tyre për të nxitur urrejtje dhe dhunë, për shembull për qëllime elektorale apo përfitime politike.

XI. Ne njëjloj zotohemi për **të mos për të shtypur zërat kritikë** dhe pikëpamjet mbi çështjet e fesë apo besimit, sado të gabuara ose fyese që mund të perceptohen, në emër të “shenjtërisë” së lëndës tematike dhe nxisim Shtetet që ende kanë ligje kundër blasfemisë apo kundër apostazisë që t’i shfuqzojnë ato, sepse ligjet e tilla kanë një ndikim mbytës në gëzimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë apo besimit, si dhe në dialogun e shëndoshë dhe debatin në lidhje me çështjet fetare.

XII. Ne zotohemi për të **rafinuar më tej kurrikulat, materialet dhe tekstet mësimore** kudo që disa interpretime fetare, apo mënyra si ato janë paraqitur, mund t’i hapin udhë perceptimit të pranimit dhe lejimit të dhunës ose diskriminimit. Në këtë kontekst, ne marrim detyrimin për të promovuar respektin për pluralizmin dhe diversitetin në fushën e fesë apo besimit, si dhe të drejtën për të mos për të marrë edukatë fetare që është në kundërshtim me bindjen e dikujt. Ne gjithashtu zotohemi për të **mbrojtur lirinë akademike dhe lirinë e shprehjes**, në përputhje me Nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, në kuadër të diskutimit fetar me qëllim të promovimit se të menduarit fetar është në gjendje të përballet me sfidat e reja, si dhe të lehtësojë të menduarit e lirë dhe kreativ. Ne zotohemi për të mbështetur përpjekjet në fushën e reformave fetare në fushat arsimore dhe institucionale.

- “E vetmja bazë e mundshme për një moral të shëndoshë është toleranca dhe respekti i ndërsjellë.” (A.J. Ayer)

- XIII. Ne marrim detyrimin për të ndërtuar mbi përvojat dhe mësimet e nxjerra nga **angazhimi me fëmijët dhe të rinjtë**, të cilët ose janë viktime të, ose janë të prekshëm prej, nxitjes së dhunës në emër të fesë, në mënyrë që të dizajnohen metodologjitë dhe mjetet dhe narrativet e përshtatura për t'ia mundësuar komuniteteve fetare që të merren me këtë fenomen në mënyrë efektive, me vëmendje të veçantë në rolin e rëndësishëm të prindërve dhe familjeve, në zbulimin dhe trajtimin e shenjave të hershme të prekmërisë së fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna në emër të fesë.
- *“Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re, por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi. (1 e Timoteut 4:12)*
- XIV. Ne marrim detyrimin për të promovuar, në sferat tona përkatëse të ndikimit, nevojën e domosdoshme për të siguruar **respekt për të gjitha aktivitetet e ndihmës humanitare të Parimeve të Sjelljes për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe OJQ-ve në Programet e Reagimit ndaj Fatkeqësive,**⁶ veçanërisht që ndihma jepet pavarësisht besimit të marrësit dhe pa asnjë dallim të pafavorshëm të çfarëdo lloji dhe se ndihma nuk do të përdoret për të çuar më tej një qëndrim të caktuar fetar.
- XV. Ne marrim detyrimin **as për të detyruar njerëzit dhe as për të shfrytëzuar personat në situata të prekshme** për t'u konvertuar nga feja apo besimi i tyre, duke respektuar plotësisht lirinë e të gjithëve për të pasur, për të përvetësuar ose për të ndryshuar fenë apo besimin, dhe të drejtën për ta manifestuar atë nëpërmjet mësimdhënies, praktikave, adhurimit dhe respektimit, individualisht ose në bashkësi me të tjerët, dhe në publik ose privatisht.
- XVI. Ne zotohemi për **levimin e peshës shpirtërore dhe morale të feve dhe besimeve** me qëllim të forcimit të mbrojtjes së të drejtave universale të njeriut dhe zhvillimin e strategjive parandaluese që ne ia përshtatim konteksteve tona lokale, duke përfituar nga mbështetja e mundshme e subjekteve relevante të Kombeve të Bashkuara.
- *“Duaje të afërmin tënd porsi vetveten. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këta” (Marku 12, 31)*
 - *“Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bëni të mirë dhe jepni hua pa pasur shpresë për asgjë, dhe shpërblimi juaj do të jetë i madh” (Luka 6, 35)*
 - *“Qenia e vetëdijshme për Perëndinë është gjithmonë e panjolllosur, si dielli, që jep ngushëllimin dhe ngrohtësinë e vet për të gjithë. Qenia e vetëdijshme për Perëndinë i shikon të gjithë njësoj, si era që fryn në mënyrë të barabartë mbi mbretin dhe lypësin e varfër.” (Guru Granth Sahib, f. 272)*
 - *“Feja e Perëndisë dhe ligji i Tij hyjnor janë instrumentet më të fuqishme dhe më të sigurta nga të gjitha mjetet për agimin e dritës së unitetit midis njerëzve. Përparimi i botës, zhvillimi i kombeve, qetësia e popujve dhe paqja e të gjithë atyre që banojnë mbi tokë janë ndër parimet dhe urdhëresat e Perëndisë.” (Bahá'u'lláh)*
- XVII. Ne zotohemi për të mbështetur njëri-tjetrin në nivelin e zbatimit të kësaj deklaratë nëpërmjet **shkëmbimit të praktikave**, ngritjes së përbashkët të kapaciteteve dhe aktiviteteve të rregullta të përditësimit të shkathtësive për predikuesit fetarë dhe shpirtërorë, mësuesit dhe instruktorët, veçanërisht në fushat e komunikimit, pakicave fetare apo të besimit, ndërmjetësimit ndërkomunitar, zgjidhjes së konflikteve, zbulimit të hershëm të tensioneve komunitare dhe teknikat korrigjuese. Në këtë drejtim, ne do të shqyrtojmë mënyrat e zhvillimit të **partneriteteve** të qëndrueshme **me institucione të specializuara akademike** në mënyrë që të promovohen kërkimet ndërdisiplinore për çështje specifike që lidhen me besimin dhe të drejtat dhe për të përfituar nga rezultatet e tyre që mund të futen në programet dhe mjetet e koalicionit tonë për Besim për të Drejta.
- XVIII. Ne marrim detyrimin për **të përdorur mjetet teknologjike në mënyrë më kreative dhe konsistente** me qëllim që ta shpërndajmë këtë deklaratë dhe mesazhet vijuese për Besim për të Drejta për rritjen e shoqërive kohezive të begatuara nga diversiteti, duke përfshirë atë në fushën e feve dhe besimeve. Ne gjithashtu do të konsiderojmë mjetet për të prodhuar vegla për ngritje të kapaciteteve fuqizuese dhe shtrirje të informimit në terren, dhe për t'i vënë ato në dispozicion në gjuhë të ndryshme për përdorim në nivel lokal.

¹ Shih UN Doc. A/HRC/22/17/Add.4, annex, appendix, para. 36.

² Shih Nenin 18 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike: “(1) Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. (2) Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij. (3) Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve. (4) Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.”

³ Këtu përfshihen Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (1948); Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatëve (1951); Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1966); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979); Konventa kundër Torturës dhe Trajtitit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës (1984); Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (1989); Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (1990); Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006); dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë (2006).

⁴ Këtu përfshihen Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948); Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Mostolerancës dhe të Diskriminimit të bazuara në Fe apo Besim (1981); Deklarata për të drejtat e personave pjesëtarë të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore (1992); Parimet e Sjelljes për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe OJQ-ve në Programet e Reagimit ndaj Fatkeqësive (1994); Deklarata e UNESCO-s mbi Parimet e Tolerancës (1995); Dokumenti përfundimtar i Konferencës Ndërkombëtare Konsultative mbi Edukimin në shkollë në lidhje me Lirinë e Fesë apo Besimit, Tolerancën dhe Mosdiskriminimin (2001); Parimet Udhëzuese të Toledos për Mësimdhënie në lidhje me Fetë dhe Besimet në Shkollat Publike (2007); Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve Vendës (2007); Deklarata e Hagës mbi “Besimin në të Drejtat e Njeriut” (2008); Parimet Camden mbi Lirinë e Shprehjes dhe Barazisë (2009); Rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 16/18 mbi Luftimin e Mostolerancës, Stereotipave Negativë dhe Stigmatizimit të, dhe Diskriminimit, Nxitjes për Dhunë dhe Dhunës ndaj Personave bazuar në Fe apo Besim (dhe Procesi i Stambollit, 2011); Plani i Veprimit i Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore apo fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë (2012); Korniza e Analizës për Krimet e Mizorisë (2014); Plani i Veprimit i Sekretarit të Përgjithshëm për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2015); si dhe Deklaratën Fez për parandalimin e nxitjes për dhunë që mund të çojë në krime të mizorisë (2015).

⁵ Të gjitha citimet nga tekstet fetare apo të besimit u ofruan nga pjesëmarrësit e punëtorisë së Bejrutit në lidhje me fenë apo besimin e tyre dhe janë vetëm për qëllim ilustrues dhe nuk janë shteruese.

⁶ Shih www.icrc.org/eng/assets/files/publications/icrc-002-1067.pdf.